# Plani i Kujdesit Social

# Bashkia Bulqizë

# 2019 - 2023

**Muaj, Viti**

**Miratuar me Vendim te Keshillit Bashkiak nr.24, date 17/05/2019**

Plani i Kujdesit Social ështe hartuar nga Bashkia Bulqizë në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërise civile, me mbështetjen teknike të Fondacionit "Ndihmë për Fëmijët" në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve te Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas" që financohet nga Agjensia Zvicerane pë Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP.

TABELA E PERMBAJTJES

1.HYRJE....3

2. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLANIT TË KUJDESIT SOCIAL....4
2.1 QËLLIMI I PLANIT TË KUJDESIT SOCIAL....4
2.2 VLERAT, PARIMET DHE QASJET....4
2.2.1 VLERAT....4
2.2.2 PARIMET....5
2.2.3 QASJET....5
2.3 PROCESI....6

3. ANALIZA E SITUATËS....6
3.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË BULQIZË....6
3.2 TË DHËNA DEMOGRAFIKE....7
3.3 ARSIMI....8
3.4 SHËRBIMET SHËNDETSORE....9
3.5 EKONOMIA....9
3.6 TREGU I PUNËS....9
3.7 VARFËRIA....11
3.8 GRUPET VULNERABËL DHE NË RISK....13
3.8.1 FËMIJET NË RISK....13
3.8.2 PUNËSIMI TEK TË RINJTË DHE PËRGATITJA PËR TREGUN E PUNËS....16
3.8.3 GRATË ME PROBLEME SOCIALE DHE DHUNA NË FAMILJE....16
3.8.4 TË MOSHUAR TË VETMUAR....16
3.8.5 PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (PAK)....17
3.8.6 KOMUNITETET....18
3.8.7 FAMILJET E PASTREHA....18

4.VLERËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, PROFESIONALE DHE FINANCIARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL....18
4.1 ORGANIZIMI I BASHKISË BULQIZË....18
4.2 DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL....18
4.3 SHËRBIMET EGZISTUESE TË KUJDESIT SOCIAL....19
4.5 BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET PËR TË OFRUAR SHËRBIME TË KUJDESIT SOCIAL....19
4.6 BURIMET FINANCIARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE NË BASHKINË BULQIZË....20
4.7 SHOQATAT QË OFROJNË SHËRBIME TË KUJDESIT SOCIAL NË BASHKINË BULQIZË....20
4.8 ÇËSHTJET KRITIKE....21
4.9 SFIDAT PËR TË ARDHMEN....21

5. FUSHAT, QELLIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË KUJDESIT SOCIAL....22

ANEKSI 1. ANALIZA SWOT....26

ANEKSI 2 PLANI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT....28
KAPACITETET INSTITUCIONALE PËR MONITORIM DHE VLERËSIM....28
INSTRUMENTET E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT....29
SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT....29

ANEKSI 3. KOSTIMI DHE HENDEKU BUXHETOR....31
SHENIME TE PERGJITHSHME....31
PERMBLEDHJE E KOSTOS SE PLANIT TE VEPRIMIT....31
REZULTATET KRYESORE DHE KONKLUZIONET NGA PROCESI I KOSTIMIT....31
REKOMANDIME PER BUXHETIMIN E PKS BASHKISE BULQIZE....32

# 1.Hyrje

Ndryshimet ekonomike dhe shoqërore, fuqizimi i njësive vendore dhe nevojat për shërbime të reja më pranë komunitetit sollën kërkesën për një reformim të sistemit të mbrojtjes shoqërore në përgjithësi sidhe nevojën për hartimin e Planeve të Kujdesit Social të përshtatura për nevojat e veçantatë komuniteteve.

Reforma në fushën e shërbimeve sociale ka në themel të saj ngritjen e shërbimeve në nivel komunitar, atje ku janë individët, familjet dhe grupet në nevojë, në mënyrë që ata tëvet-funksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë me anëtarët e tjerë të shoqërisë. Kjo reforme shkon në harmoni me procesin e decentralizimit të kompetencave dhe përgjegjësive të pushtetit vendor për krijimin e një sistemi komunitar shërbimesh, ku individi ndihmohet dhe mbeshtetet në mjedisin ku ai jeton, duke respektuar, personalitetin, vlerat, aftesitë, veçoritë, preferencat dhe burimet e tij.

Plani i Kudesit Social i Bashkisë Bulqizëbën një fotografim të situatës sociale dhe ekonomike të komunitetit që jeton në territorin e kësaj bashkiesi dhe nje analizë të nevojave të grupeve të veçanta të këtij komuniteti për shërbime të kujdesit social. Në pjesën e dytë, dokumenti përmban qëllimet, objektivatdhe masat të artikuluara nga aktorët e përfshire në procesin e hartimit të planit, të cilat priten të ndikojnë në përmirësimin e jetës së grupeve tëperjashtuara të popullatës, si dhe nevojën për burime materiale, financiare e njerzore për realizimin e këtyre masave, për periudhën 2019-2023.

Planiështë në koherencë me: Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social 2015-20, Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2015–2020), Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm, Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", "Dokumentin e politikave të decentralizimit të ndihmës dhe shërbimeve sociale", Ligjin nr. 121/ 2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"dhe dokumenta të tjerë specifikë.

Plani tregon rrugën dhe qasjen për të adresuar nevojat për shërbime sociale të grupeve të përjashtuara, jep zgjidhjet për të përballuar vështirësitë dhe inkurajon përhapjen e parimit të bashkëjetesës sociale në të gjithë territorin e bashkisë.

Plani i Kujdesit Social shpreh vullnetin politik dhe moral të qeverisë vendore për t'u angazhuar në zgjidhjen e problemeve sociale të komunitetit jo vetëm me burime publike vendore por edhe duke ndërtuar partneritete efikase me shoqërinë civile, biznesin dhe partnerët ndërkombëtarë, duke i dhenë një dimension të ri rrolit të të gjithë aktorëve në ofrimin e shërbimeve sociale.

## 2. Metodologjia e Hartimit të Planit të Kujdesit Social

Njësia e qeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave lokale, programimin e fondeve dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit social[1]. Në këtë kuadër iniciativa për hartimin e Planit të Kujdesit Social është e bashkisë Bulqizë, por në respekt të parimit të gjithëpërfshrjes nëprocesin për hartimin e tij janë përfshirë të gjithë aktorët të cilëtjo vetëm njohin nevojat sociale të komunitetit, por marrin edhe përgjegjësinëpër ofrimin e shërbimeve.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij dokumenti zbaton një qasje analitike të të dhënave dhe dokumentacionit të siguruar nga Bashkia Bulqizë, kombinuar me një proces dialogu me aktorët e interesuar. Qasja analitike bën të mundur analizën, sintezën dhe nxjerrjen e përfundimeve nga dokumentat ekzistues, siç janë: të dhënat administrative, plani i zhvillimit i bashkisë, plani buxhetor afatmesëm, profili social i bashkisë etj.

### 2.1 Qëllimi i Planit të Kujdesit Social

Qëllimi i Planit tëKujdesit Socialështë të hartojë
një politikë të qartë lokale për sigurimin e shërbimeve të kujdesit social për grupet në risk që jetojnënë territorin e bashkisë Bulqizë. Plani do tëshërbejë si një udhërrëfyes përadministratën e bashkisë në përmbushje të misionit të saj për të ndihmuar individët, familjet dhe grupettë cilët nuk kanë mundësi t'ja dalin vetë.Plani synon gjithashtu fuqizimin e vendimmarrësve, menaxherëve dhe profesionistëve me mekanizma për zbatimin e politikave sociale në nivel lokal.Për këtë qëllim, Drejtoria e Shërbimit Social në bashki që hartoi këtë dokument u ndihmua edhe nga përfaqësues të institucionevetë tjera lokale si zyra arsimore, zyra e punës, sporteli i shërbimit QKB, ekspertë të fushës, dhe përfaqsues të organizatave të shoqërisë civiletë cilët kanë dijeni mbi nevojat dhe ofrojnë shërbime në këtë sektor.

### 2.2 Vlerat, Parimet dhe Qasjet

Plani i Kujdesit Social lokal është një reflektim ndaj qëllimeve, prioriteteve dhe nevojave të komunitetit, prandaj hartohet duke u mbështetur në situatën ekzistuese demografike, ekonomike e sociale të tij.

#### 2.2.1 Vlerat

PKS i Bashkisë Bulqizë përcjell vlerat e mëposhtëme:

- qytetari është i pari – nevojat dhe dëshirat e qytetarëve janë konsideruar si prioritet;
- interesi publik – plani i kujdesit social është njëçështje me interes publik, për këtë arsye procesi i hartimit të tij ka perfshirë grupet e interesuara;
- mundësi të barabarta –çdonjeri duhet të ketë mundësi të barabarta në arritjen e shërbimeve të kujdesit social;
- pjesmarrje në vendimarrje - mundesimi i pjesmarjes së përdoruesëve dhe ofruesëvetë shërbimeve në hartimin dhe monitorimin e PKS-së.

[1]Ligji nr. 121/2016 për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë dhe të Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

### 2.2.2 Parimet

Parimet që udhëhoqën hartimin e Planit janë:

- *Pronësia vendore e Bashkisë Bulqizë*

E hartuar për t'ju përgjigjur nevojave për shërbime sociale të komunitetit që jeton në territorin e Bashkise Bulqizë, përgjegjësinë në realizimin e synimeve dhe objektivave e ka Bashkia, si institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve sociale komunitare. Pronësia vendore është realizuar edhe gjatë procesit të hartimt të Planit i ciliështë nje produkt i përpjekjeve të përbashkëta ispecialisteve të bashkisë, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtar.

- *Qëndrueshmëria e Planit (mbështetja kryesisht në burime lokale)*

Efekti financiar i Planit të Kujdesit Social do të mbulohet kryesisht nga buxheti i Bashkisë Bulqizë, i lidhur dhe i harmonizuar me planin buxhetor afatmesëm, strategjitë sektoriale si ajo e arsimit, mbrojtjes sociale, shëndetësisë dhe punësimit. Bashkia do të jetë e vëmendëshme për të përshtatur çdo vit, mbi bazën e rezultateve të monitorimit objektivat dhe aktivitetet, me situatën reale të krijuar.

- *Gjithëpërfshirja*

Parimi i gjithëperfshirjes në procesin e hartimit të Panit Social u sigurua nëpërmjet organizimit të grupeve të fokusuara me specialistë të sektorëve përkatës (shërbime sociale dhe buxhetit-financës) dhe organizimit të tryezave të rrumbullakta me grupet e interesit (shoqata), të cilat ofruan të dhëna mbi situaten sociale të grupeve të veçanta dhe artikuluan çeshtjet kritike lidhur me shërbimet e kujdesit social për këto grupe.

- *Politika e balancuar (qendrore-vendore)*

Plani Social, është një plan sektorial, dhe mbështetet në prioritetet e Bashkisë Bulqizë për të adresuar nevojat sociale të komunitetit. Dokument synon të koordinojë veprimet dhe aktivitetet me sektorë të tjerë të shërbimeve lokale siç janë: arsimi, shëndetësia, shërbimet e punësimit, madje edhe me sektorë të tjerë të pavarur siç janë OJF-të dhe biznesi. Ndërveprimi dhe bashkërendimi i veprimeve ndërmjet sektorëve, qëndron edhe në faktin se ky plan synon në krijimin e një sistemi informacioni efiçent, ku secili prej sektorëve do të pasurojë dhe do të ndihmojë, në identifikimin dhe mbështetjen e individeve, familjeve ose grupeve në nevojë[2].

### 2.2.3 Qasjet

Në të gjitha fazat, atë të hartimit, zbatimit dhe monitorimit, Plani synon qasjet e mëposhtme:

- Mbështetjen në evidenca;
- Perspektivën gjinore;
- Qasjen multidisiplinare;
- Të drejtat e njeriut;
- Diversitetin socio-kulturor;
- Vullnetin politik dhe qeverisjen e mire;
- Bashkëpunimin.

[2] NARU

**2.3 Procesi**

Plani Social është ndërtuar në bazë të« modelit logjik të planifikimit », i cili parashikon një numër hapash sipas një kalendari të përcaktuar nga Bashkia Bulqizë.

1. Vlerësimi i nevojave të Bashkisë Bulqizë për shërbime sociale, përcaktimi i çështjeve kritike dhe vendosja e prioriteteve;
2. Vlerësimi i kapaciteteve lokale, materiale, financiare dhe njerëzore, për të ofruar shërbime të kujdesit social;
3. Përcaktimi i synimeve dhe objektivave në permbushje të vizionit të Bashkisë Bulqizë[3] « Bulqiza, komunitet në mireqenie e prosperitet të vazhdueshëm, e pastër, e gjelbër dhe me akses të permiresuar në shërbimet bazë për të gjthë komunitetin»;
4. Përcaktimi i planit të veprimit duke respektuar koherencën e brendëshme ndërmjet objektivave, aktiviteteve, rezultateve të pritëshme, tregueseve të monitorimit të rezultateve dhe organizatave bartëse të detyrave ;
5. Kostimi i aktiviteteve tëplanit, bazuar nënjë metodologji të hartuar nga ekspertët qëndihmuanprocesin dhe të mbeshtetur nëprogramin buxhetor afatmesëm 2018-2020.
6. Hartimi i planit të monitorimit të Planit të Kujdesit Social.

# 3. Analiza e Situatës

Vlerësimi i nevojave për shërbime të kujdesit social dhe vleresimi i kapaciteteve lokale për të ofruar këto shërbime u bazua në të dhënat statistikore dhe administrative tëbashkisë Bulqizë, si dhe në të dhënat e siguruara nga burime të tjera siç janë : konsultimet me strukturat publike dhe jo publike të ofrimit të shërbimeve dhe intervistave me profesionistë dhe përfaqësues të këshilit bashkiak.

**3.1 Vështrim i përgjithshëm i Bashkisë Bulqizë**

Bashkia e Bulqizës shtrihet në rajonin verilindor të Shqipërisë. Në kordinanatat $41^{0}37'$ gjërësi gjeografike veriore (njësia administrative Shupenzë), $41^{0}21'30''$ gjatësi gjeografike veriore (njësia administrative Trebishtë), $20^{0}18'50''$ gjërësi gjeografike lindore, $20^{0}07'30''$ gjatësi gjeografike lindore (njësia administrative Martanesh).

Në veri kufizohet me bashkinë Dibër, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jug-perëndim me bashkinë Tiranë, në jug me bashkinë Librazhd dhe në perëndim me bashkinë Klos. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bulqizës. Gjatësia e vijës kufitare është 120 km. Nga këto gjatësia e vijës kufitare me bashkinë e Dibrës është 25 km, me bashkinë e Librazhdit 29 km, me Republikën e Maqedonisë së Veriut 30 km, me bashkinë e Klosit 23 km dhe me bashkinë e Tiranës 13 km.

Në Bashkinë e Bulqizës dallohet zona klimatike mesdhetare paramalor dhe mesdhetare malore e cila karakterizohet nga dimër i ftohtë me temperatura nën 0°C dhe me reshje të pakta.Klima

[3] Plani Operacional i Zhvillimit Lokal, përgatitur nga Bashkia Bulqizë në kuadër të projektit STAR

e kësaj lugine është mjaft e ftohtë, gjë e cila lidhet jo vetëm me lartësinë e madhe mbi nivelin e detit, por dhe me erën e fortë që frynnga lindja.

### 3.2 Të dhëna demografike

Sipas Censusit të vitit 2011 popullsia e Bulqizës është 32,210 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki ka 39,890 banorë[4]. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 678.51 $km^2$ me një densitet prej 59.28 banorë/$km^2$ sipas Regjistrit Civil dhe 47.47 banorë/$km^2$ sipas Censusit 2011.

Bashkia Bulqizë ka në përbërje 8 Njësi Administrative, të cilat janë: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren dhe Trebishtë, 2 qytete (Bulqiza dhe Krasta) dhe 63 fshatra. Sipas ndarjes se re administrative bashkia klasifikohet 26.9% urbane dhe 73.1% rurale.

**Tabelë 1 - Të dhëna për numrin e popullsisë dhe numrin e familjeve sipas njësive administrative të bashkisë Bulqizë**

| Njësitë Administrative | Nr. i popullsisë | Nr. i familjeve |
|---|---|---|
| **Bashkia Bulqizë** | 12,181 | 3664 |
| **Fushë-Bulqizë** | 4072 | 1155 |
| **Gjoricë** | 5330 | 1532 |
| **Martanesh** | 2201 | 700 |
| **Ostren,Klenjë** | 4178 | 1387 |
| **Shupenzë** | 6904 | 1855 |
| **Zerqan** | 5024 | 1502 |
| **Trebishtë** | | |
| **Totali** | **39.890** | **11.795** |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Gjendjes Civile Bashkia Bulqizë*

Referuar piramidës së moshës, fëmijët ose grupmosha 0-14 vjeç përbën 26% të popullsisë, ajo 15- 64 vjeç përbën 65.6% te popullsisë, ndërsa të moshuarit ose grupmosha mbi 65 vjeç përbën 8.3% te saj. Struktura e popullsise sipas gjinisë rezulton me 49.6% gra dhe 50.4% burra. Gjatë vitit 2017 shtesa natyrore e popullsisë (diferenca lindje vdekje) është me 296 banore duke patur një rritje me 8.4% krahasuar me një vit me pare. Treguesit demografik të zonës janë të lidhur edhe me profilin social ekonomik të saj. Kështu sipas INSTAT 2011, 12.8% e familjeve drejtohen nga kryefamiljare femra.

Analiza demografike tregon se gjatë periudhës 2001-2011, tendenca e popullsisë ka qenë në rënie, duke u ndikuar nga migrimi i brendshëm dhe i jashtëm si dhe nga nje rënie e lehtë e normës së lindshmërise. Tkurrja më e madhe vihet re në zonat e thella malore si në Martanesh me 48.22%, ndjekur nga Ostreni me 37.51%. Rënien më të vogël të numrit të popullsisëe ka

[4]Burimi i të dhënave Bashkia Bulqizë, 2018

Fushë-Bulqiza me 19.59%. Megjithatë, duhet thënë se për shkak të mundësive të punësimit, tendenca e shpopullimit të bashkisë paraqitet më e vogël se tendenca në niveli qarku (27.8%).

### 3.3 Arsimi

Në Bashkinë Bulqizë ka 3 kopshte, 51 shkolla 9-vjeçare dhe 6 shkolla të mesme, 88% e të cilave ndodhen në zonat rurale. Për shkak të shtrirjes gjeografike, nxënësit e fshatrave të thella, detyrohen të përshkojnë rrugë të gjata për të frekuentuar shkollat më të afërta. Një pjesë e tyre edhe në kushtet e dimrit të ashpër dhe motit te keqe bëjnë rrugën me këmbë ose me mjete të rastit. Në lidhje me infrastrukturën arsimore vihet re në mjaft raste se ajo është e vjetër. Po kështu mungojnë ambjentet sportive, si palestra e fusha sporti. Megjithëse bëhen përpjekje për rritjen e nivelit arsimor e kulturor të të rinjve, mungojnë mjediset e bibliotekave pranë shkollave.

**Tabelë 2 - Arsimi parashkollor nëbashkinë Bulqizë, për vitin 2018**

| Viti 2018 | Numri i kopështeve | Numri i fëmijëve | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|---|
| Kopështe publike | 3 | 264 | 116 | 148 |
| Grupet parapërgatitore | 7 grupe | 432 | 238 | 194 |

*Burimi: Bashkia Bulqizë*

**Tabela 3 - Të dhëna për numrin e nxënësve në bashkinë Bulqizë, për vitin 2018**

| | Numri i shkollave | Numri i nxënësve | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|---|
| Arsimi i detyruar | 51 | 3876 | 1769 | 2107 |
| Arsimi i mesëm | 6 | 1095 | 534 | 561 |

*Burimi: ZA Bashkia Bulqizë*

Në lidhje me arsimin e mesëm, universitar dhe pasuniversitar, bashkia ka tregues të ulët të nivelit arsimor në krahasim me qarkun dhe me vendin. Rreth 22.7% e popullsisë 15 vjeç e lart ka përfunduar arsimin e mesëm (të përgjithshëm ose profesional), ndërkohë rreth 4.0% ka përfunduar arsimin universitar ose pasuniversitar (në krahasim me 24.26% dhe 5.2% në nivel qarku dhe 31.4% dhe 11.8% në nivel vendi).

Nga të dhënat rezulton se për çdo vit numri i nxënësve në të gjithë sistemin arsimor brenda territorit të bashkisë është në rritje për shkak të:

- lëvizjeve migruese;
- lëvizjeve të nxënësve nga komunat Fushë Bulqizë e Zerqan në drejtim të shkollave të qytetit të Bulqizës për shkak të cilësisë më të mirë të mësimdhënies;
- frektuentimit tështkollës së mesme të qytetit, të cilën e ndjekin nxënës pothuajse nga të gjithë komunat e rrethit;
- degëve të reja të arsimit profesional që janë hapur vitet e fundit (pedagogjike), etj;

Problemet e arsimit në Bashkinë Bulqizë janë si më poshtë[5]:

[5] Problemet jane artukuluar nga pjesmarresit ne tryezat e rrumbullakta, realizuar gjate procesit te hartimit te PKS

- Numër i madh i nxënësve për një mësues, veçanërisht në qytet;
- Distanca të largëta të shkollave sidomos në zonat rurale;
- Mungesa e transportit;
- Performancë dhe rezultate të ulta të nxënësve;
- Mundësi trajnimi e kufizuar;
- Mungesë të laboratorëve dhe mjeteve didaktike të nevojshme, etj.

Vitet e fundit në bashkinë Bulqizë është hapur Shkolla Profesionale Gjeologji Miniera. Kjo Shkollë është hapur me mbështetjen e ndërmarrjes Alb Crom (ACR) e cila mbështet me bursë të plotë të gjithë nxënësit e kësaj shkolla. Burst e akorduara nga ACR kapin vlerën 7.000 – 8.000 lek në muaj dhe në përfindim të shkollës pothuajse 100% e studentëve punësohen. Kjo shkollë ka një cikël 4 vjeçar dhe studiojnë në total rreth 120 nxënës (35/ 40 nxënës për cdo vit mësimor).

### 3.4 Shërbimet shëndetsore[6]

Bashkia Bulqizë ka më pak se 1/4 e qendrave shëndetësore në qark. Pothuajse të gjitha qendrat ndodhen në zona të largëta. Shërbimi shëndetësor ofrohet nga 8 qendra shëndetësore dhe 37 ambulanca.

### 3.5Ekonomia

Aktiviteti ekonomik është i orientuar në bujqësi, blegtori dhe industrinë minerare. Bujqësia është e organizuar në ferma të vogla familjare me sipërfaqe të vogël të tokës së punueshme. Zona ka klimë të përshtatëshme për zhvillimin e arroreve, foragjereve, frutikulturës, vreshtarisë, etj. Rreth 34.5% e të punësuarve në Bulqizë janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë. Ndërkohë, një tjetër burim i rëndësishëm për zhvillimin aktiviteteve ekonomike të kësaj zone konsiderohet edhe turizmi malor familjar si dhe ngritja e qendrave për grumbullimin e bimëve medicinale, me të cilat zona është mjaft e pasur.

Qyteti i Bulqizës, ështëi ndërtuar në funksion të industrise minerare dhe rezervave të mëdha të kromit. Falë kësaj pasurie, në Bulqizë 40% e ndërmarjeve i përkasin industrisë minerare, ku janë të punësuar rreth 70% e numrit të të punësuarve në zonë[7].

Burimi i të ardhurave[8] të njësisë ekonomike familjare në Bulqizë është puna e paguar ose vetëpunësimi me 41.2%. Një peshë të lartë në burimin e të ardhurave për familjet e Bulqizës mbajnë pensionet me 34.7% dhe ndihma ekonomike dhe përfitimet nga skemat e mbrojtjes shoqërore në kesh me 31.1%.

### 3.6Tregu i punës

Po ti referohemi punësimit sipas sektorëve konstatojmë se 77 përqind e të punësuarëve i përket sektorit të kromit, dhe 23 përqind i përket formave të tjera të punësimit.

---

[6]Plani Operacional i Zhvillimit Lokal (POZHL), hartuar ne kuadrin e projektit STAR
[7] Të dhëna administrative nga zyra e punës Bulqizë
[8] https://instatgis.gov.al/#!/l/prefectures/population/prefpop1

**Tabelë 4 - Punësimi sipas sektorëve ekonomik**

| Nr. | Aktiviteti ekonomik | Totali i subjekteve | Të punësuar |
|---|---|---|---|
| **1** | Krom | 71 | 2859 |
| **2** | Energji | 8 | 85 |
| **3** | Ndërtim | 7 | 268 |
| **4** | Tregti+fizike | 64 | 165 |
| **5** | Transport | 3 | 25 |
| **6** | Aktivitete ushqimore | 2 | 14 |
| **7** | Të tjerë(roje) | 6 | 133 |
| **8** | Të ndryshme | 7 | 107 |
| **9** | Pyjet | 2 | 15 |
| **10** | Përpunimi i drurit | 1 | 20 |
| Nr | **Totali** | **171** | **3691** |

*Burimi i të dhënave: Zyra e Punës Bulqizë, Dhjetor 2018*

Siç tregohet në tabelën nr. 3, më poshtë, në sektorin privat vihet re nje numër shumë i ulët i punësimit të grave, në krahasim me burrat. Ndërsa vihet re një punësim më i madh i grave në sektorin buxhetor, apo ndërmarrjet shtetërore.Referuar të dhënave të zyrës së punës, pjesmarja në forcat e punës për Bashkinë Bulqizë ndjek një trend pothuaj konstant përgjatë pesë viteve të fundit. Në vitin 2012 pjesmarja ishte rreth 55% e individëve të aftë për punë, duke arritur në nivelin maksimal në vitin 2017 me rreth 59%. Gjithësesi, shkalla e pjesmarjes në forcat e punës tek gratë është shumë më e ulët se tek burrat.

**Tabelë 5 - Të punësuar në sektorin privat të ndarë sipas gjinive**

| TOTAL SUBJEKTE | TOTAL PUNESUAR | TOTAL MESHKUJ | TOTAL FEMRA |
|---|---|---|---|
| **171** | **3691** | **3196** | **495** |

*Burimi i të dhënave: Zyra e Punës Bulqizë, Dhjetor 2018*

**Tabelë 6 - Të punësuar në ndërmarrjet buxhetore (3-mujori i katërt 2018)**

| Nr. | Ndërmarrja buxhetore | Nr. i të punesuarve | Femra | Meshkuj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nënprefektura | 3 | 1 | 2 |
| 2 | Zyra arsimore | 393 | 262 | 131 |
| 3 | Dega thesarit | 3 | 2 | 1 |
| 4 | Zvrpp Bulqizë | 5 | 1 | 4 |
| 5 | Nd.pastrim gjelbërimi | 59 | 24 | 35 |
| 6 | Bashkia | 296 | 146 | 150 |
| 7 | Spitali | 105 | 79 | 26 |
| 8 | Dr. Shendetit publik | 23 | 14 | 9 |
| 9 | Zyra e punës | 5 | 4 | 1 |
| 10 | Drlfpp | 6 | 2 | 4 |
| 11 | Sig. Shoqerore | 8 | 6 | 2 |
| | **TOTALI** | **906** | **541** | **365** |

*Burimi i të dhënave: Zyra e Punës Bulqizë, Dhjetor 2018*

Në ndërmarrjet publike jo-buxhetore si qendrat shëndetësore, apo ujësjellësi dhe posta 70% e të punësuarve janë ferma dhe vetëm 30% janë meshkuj.

**Tabelë 7 - Të punësuar në ndërmarrjet jobuxhetore (3-mujori i katërt 2018)**

| Nr | Ndërmarrja buxhetore | Nr. i të punësuarve | Femra | Meshkuj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Q. Shend. Fush-Bulqizë | 7 | 7 | 0 |
| 2 | Q. Shend. Martanesh | 17 | 11 | 6 |
| 3 | Q. Shend. Shupenzë | 25 | 21 | 4 |
| 4 | Q. Shend. Gjoricë | 14 | 12 | 2 |
| 5 | Q. Shend. Ostren | 17 | 13 | 4 |
| 6 | Q. Shend. Tebisht | 7 | 5 | 2 |
| 7 | Q. Shend. Bulqizë | 24 | 23 | 1 |
| 8 | Q.shend. Zerqan | 16 | 15 | 1 |
| 9 | Sha. Ujesjellësi Bulqizë | 24 | 7 | 17 |
| 10 | Sha. Ujesjellësi Kraste | 16 | 4 | 12 |
| 11 | Posta | 24 | 17 | 7 |
| | **Totali** | **191** | **135** | **56** |

*Burimi i të dhënave: Zyra e Punës Bulqizë, Dhjetor 2018*

Shkalla e papunësisë tekgratë dhe të rinjtë është veçanërisht shqetësuese në bashkinë Bulqizë. Shkalla e papunsise tek gratëështë37.4% ndersa tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç arrin në 64.3%. Të dhënat administrative nga zyra e punës Bulqizë tregojnë se reth 35.3% e punëkërkuesve të papunë janë kryefamiljarë[9].

### 3.7 Varfëria

Me gjithë ndryshimet social ekonomike në vitet e fundit, Bulqiza mbetet një nga qytetet më të varfëra të Shqipërisë, ku të ardhurat për frymë janë nga më të ultat në vend. Edhe brenda territorit të bashkisë, varfëria ka një dimension të theksuar gjeografik ku zonat malore, veçanërisht ato të zonës së Martaneshit janë edhe zonat më të varfëra[10].

Sipas të dhënave të "Hartës së varfërisë dhe pabarazisë në Shqipëri", Rajoni i Dibrës (pjesë e së cilës është bashkia e Bulqizës) është rajoni me numurin më të madh të të varfërve. Niveli i varfërisë në rajon është 37,98% . Ndërsa koeficienti GINI (koeficienti i pabarazisë) në këtë rajon është 0,60 . Zonat më të varfëra të bashkisë janë Martaneshi ku niveli i varfërisë arrin në 43 % , dhe Fushë Bulqiza ku më shumë se 43 % e popullsisë jetojnë në varfëri. Të dhënat administrative tregojnë se një peshë të rëndësishme të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, rreth 21% e përbëjnë familjet me kryefamiljare gra.

Treguesi më i rëndësishëm i varfërisë (që mund të matet në nivel të njësisë vendore) është përqindja e popullsisë në skemën e ndihmës ekonomike. Familjet përfituese të ndihmës

[9] Plani Operacional i Zhvillimit Lokal, Bashkia Bulqizë 2016
[10] INSTAT dhe BB 2017

ekonomike nuk kanë të ardhura ose i kanë ato të pamjaftueshme. Aktualishtnëbashkinë Bulqizë përfitojnë ndihmë ekonomike rreth 1511familje, që do të thotë se rreth 12% e familjeve në këtë bashki jetojnë në varfëri ekstreme. E parë nëkëtë këndvështrim, reduktimi i varfërisëështë edhe një nga sfidat kryesore tëbashkisë.

**Tabelë 8 - Të dhëna të skemës së ndihmës ekonomike sipas viteve.**

| Indikatorët/Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| Nr. i familjeve që aplikojnë për ndihmë ekonomike | 2,812 | 2,135 | 2,067 | 1,511 |
| Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike | 2,222 | 1,928 | 1,948 | 1,257 |
| Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike nga komuniteti Egjyptian | - | - | - | 21 |
| Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike PAK | 232 | 215 | 186 | 175 |
| Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me statusin Jetim | 4 | 4 | 4 | 5 |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

Sipas të dhënave të "Hartës së varfërisë dhe pabarazisë në Shqipëri", Rajoni i Dibrës (pjesë e së cilës është bashkia e Bulqizës) është rajoni me numurin më të madh të të varfërve. Niveli i varfërisë në rajon është 37,98% . Ndërsa koeficienti GINI (koeficienti i pabarazisë) në këtë rajon është 0,60 . Zonat më të varfëra të bashkisë janë Martaneshi ku niveli i varfërisë arrin në 43 % , dhe Fushë Bulqiza ku më shumë se 43 % e popullsisë jetojnë në varfëri. Të dhënat administrative tregojnë se një peshë të rëndësishme të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, rreth 21% e përbëjnë familjet me kryefamiljare gra.

**Tabelë 9 - Të dhëna për fondin e ndihmës ekonomike për vitet 2015-2018**

| Indikatorët/Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| Numri mesatar i familjeve përfituese te ndihmës ekonomike | 2,222 | 1,928 | 1,948 | 1,257 |
| Fonde e shpenzuara vjetore (ne lekë) | 122,209,176 | 121,214,088 | 116,169,552 | 63,051,120 |
| Pagesa mesatare e familjeve (vjetore) | 55,000 | 62,800 | 59,600 | 50,160 |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme numri i famileve përfituese të ndihmës ekonomike në vitin 2018 ka rënë me 43% krahasuar me vitin 2015. Por kjo rënie në numrin e familjeve përfituese nuk është shoqëruar me rritjen e pagesës mesatare për çdo familje. Të dhënat administrative tregojnë se skema e re e përfitimit ka favorizuar më së shumti familjet me 3-4 anetarë.

**Tabelë 10 - Të dhëna për ndihmën ekonomike nga granti 6%**

| Njësitë Administrative | Nr. i familjeve | Fondi 6 % |
|---|---|---|
| Bashkia Bulqizë | 42 | 141 900 |
| Gjoricë | 16 | 56 100 |

| | | |
|---|---|---|
| Fushë Bulqizë | 18 | 44 566 |
| Zerqan | 218 | 52 220 |
| Shupenzë | 176 | 58 500 |
| Martanesh | 10 | 29 100 |
| Ostren | 10 | 33 800 |
| Trebisht | 5 | 17 000 |
| Totali | **495** | **425 986** |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social*

Për të zbutur ndikimin e skemës se pikëzimit (tek familjet e varfëra) dhe formulës së përllogaritjes për masën e  përfitimit, ligji ka parashikuar një fond deri në 6% të fondit tëkushtëzuar, të cilin Këshilli i Bashkisë mund ta përdorë për të mbështetur familjet të cilat nuk janë përzgjedhur si familje përfituese nga sitemi i pikëzimit. Me këtë fond janë mbështetur rreth 495 familje. Gjithashtu nga fondet e krijuara nga të ardhurat e  Bashkisë janë mbështetur edhe 127 familje të tjera në muaj.

**Tabelë 11 - Numri i familjeve të trajtuara nga fondet e Bashkisë**

| Muajt (2018) | Nr. i familjeve |
|---|---|
| Numri mesatar i familjeve perfituese për çdo muaj gjatë vitit 2018 | 127 |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

### 3.8 Grupet vulnerabël dhe në risk

Sipas Bankës Botërore një grup vulnerabël është një popullsi me specifika që krijojnë një risk të lartë për të qënë të varfër, duke përfshirë, personat me aftësi ndryshe, të moshuarit, të rinjtë emigrantët e kthyer, minoritetet etnike (egjyptianët) dhe gratë.

Aktualisht, duke ju referuar të dhënave të Shërbimit Social në Bashkinë Bulqizë rezultojnë 14 familje të komunitetit Egjyptian, nga të cilat 13 trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 1 person ka statusin jetim.

#### 3.8.1 Fëmijet në risk

*Fëmijët qënuk ndjekin shkollën ose nuk mbarojnëarsimin e detyruar:*

Një numër konsiderueshëm i fëmijeve nga familje të varfërai largohen frekuentimit të arësimit të detyruar. Fenomeni i braktisjes së shkollës haset sinë qytet ashtu edhe në fshat, por ai mbetet fenomen që prek kryesisht fëmijët që jetojnë në zonat rurale. Kushtet e vështira ekonomike, papunësia e anëtarëve të familjes në moshë pune dhe keq-arsimimi iprindërve, ka detyruar shumë femijë tëbraktisin shkollën dhe të ndihmojnë familjet e tyre duke punuar. Nga ana tjetër largësia e madhe e shkollës nga vendbanimi dhe kushtet e këqia klimaterike janë arsye të braktisjes së shkollës.

Sipas konsultimeve të bëra në Bashkinë Bulqizë ka përqindje të lartë të fëmijëve që braktisin arsimin e detyruar dhe punësohen. Vlerësohet që qytet 9% e fëmijëve kanë braktisur arsimin e detyruar, ndërsa në zonën rurale kjo shifër është shumë më e lartë. Në Njësinë Adminsitrative Ostren 14% e nxënësve nuk mbarojnë arsimin e detyruar, ndërsa në Njësinë Administrative Gjoricë 18%.

Nga të dhënat administrative të Bashkisë Bulqizë rezulton se 61% e fëmijëve që e braktisin arsimin, janë fëmijë të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike. Korrelacioni ndërmjet varfërisë dhe braktisjes së shkollës nga fëmijët është shumë i fortë, gjë që mund të korrigjohet me skemën e re të NE, e cila parashikon masa për familjet fëmijët e të cilave nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm.

*Fëmijë të ngujuar nga problemi i gjakmarjes:*
Nëbashkinë Bulqizëekziston gjakmarja dhe si pasojë ka një numër fëmijësh të kërcënuar nga ky fenomen. Duke ju referuar të dhënave nga bashkia, numri i fëmijëve të ngujuar si rezultat i gjakmarrjes është 24 deri 30 fëmijë të cilët jetojnë në zonat rurale.

*Fëmijët jetimë*
Kjo kategori përbën 5,9%të fëmijëve të grupmoshës 0-14 vjeç, nga të cilët pjesa më e madhe janëfëmijë me një prind. Familjet e këtyre fëmijëve jetojnë në varfëri ekstreme dhe në shumicën e rasteve këtafëmijë janë potencial për të qenë femijë në situatë rruge ose femijë që punojnë.

*Fëmijët që punojnë:*
Puna e fëmijëve është një fenomen i përhapur nëbashkinëBulqizë. Fëmijët që detyrohen të punojnë në stoqet e kromit janë me dhjetëra. Puna e rrezikshme që ata bëjnë krahas nënave të tyre bën që një pjesë e tyre të jenë dëmtuar gjatë punës dhe të shfaqin shenja lodhje, ose semundje.

Në vitin 2015, në një analizë të situatës së punës së fëmijëve në Shqipëri realizuar nga instituti "Seda" me mbështetjen e Avokatit të Popullit dhe Save the Children, analizohet edhe puna në sektorin minerar në zonën e Bulqizës[11]. Studimi konstaton se në bashkinë e Bulqizës shikon shpesh fëmijë, të cilët për shkak të situatës së vështirë ekonomike apo për shkak të pamundësisë fizike të prindërve të tyre, punojnë për të ndihmuar ekonomikisht familjet, duke mbledhur krom në mënyrë informale kryesisht në dalje të minierave apo në stoqet e kromit rreth tyre. Studimi ka analizuar (nëpërmjet "desk review") edhe aktet e kontrollit të realizuara nga inspektorët e punës së Qarkut Dibër në 248 subjekte minerare me 4,818 të punësuarpër periudhën Janar – Gusht 2015, por në aktet e kontrollit nuk është gjetur asnjë evidencë për punën e fëmijëve.

| **Kutia 1.** |
| --- |

[11]http://childhub.org/en/system/tdf/library/attachments/child_labor_report_dec_2015.pdf?file=1&type=node&id=19344

“Nuk marr ndihmë ekonomike, nuk kam rrogë, nuk kam ku të punoj, kam marrë me vete dhe fëmijët” thotë nëna e tre fëmijëve e cila bashkë me ta gërmon në rrënojat e pirgjeve të braktisura pranë galerive për të mbledhur krom.

Një grua 66 vjeçare tha se e ka pensionin 50 mijë lekë të vjetra dhe se nuk i mjaftonin, ndaj ishte e detyruar të dilte të mblidhte krom. “Më ka mbuluar disa herë dheu dhe mezi kam dalë, por ç’të bëj nuk më mjafton pensioni ” tregon e moshuara , përreth së cilës mblidhnin krom nipërit dhe e grumbullonin afër saj.

Top Channel“Fiks fare”- datë 22 Tetor, 2018[12]

Po kështu ekziston edhe fenomeni i punësimit të fëmijëve në blegtori. Problem i madh për këta fëmijë janë orët e gjata të punës dhe kushtet e vështira me të cilat këta fëmijëpunëtorë duhet të përballen çdo ditë për të siguruar të ardhura minimale për të jetuar.

Gjatë vitit 2018, janë evidentuar dhe trajtuar nga bashkia 17 raste fëmijësh që punojnë, për të cilët janë marrë masat e nevojëshme dhe mbahen në monitorim. Gjithashtu janë të evidentuara rreth 25-27 “familje problemtatike”fëmijët e të cilave janë të angazhuar nëpunë. Këto familje mbahen në monitorim të vazhdueshëm nga stafi i bashkisë.

Fenomeni i fëmijëve në situatë rruge dhe ai i shfrytëzimit për lypje, është prezent në komunitetin e bashkisë Bulqizë. Përgjatë vitit 2018 janëevidentuarrreth 33 raste të cilat më pas janë trajtuar nga NjMF. Ratet e evidentuara tregojnë se pjesa më e madhe e fëmijëve në situatë rruge janë të grupmoshës 7-14 vjeç. Ata janë pjesë e familjeve të mdha me shumë anëtarë nën moshën e punës. Një pjesë e tyre janë femijë jetimë (me një prind) që ndihmojnë familjet e tyre me të ardhurat që nxjerrin nga puna në rrugë. Ndonëse identifikimi i tyre është i lehtë, është e vështirë të ofrosh shërbime sociale dhe integruese për këto fëmijë dhe familjet e tyre, pasi në territorin e bashkisë ka pak alternativa të shërbimeve sociale të përshtatëshmepër këtë kategori.

**Tabelë 12 - Numri i rasteve të fëmijëve në situatë rruge për vitin 2018**

| **Bashkia Bulqizë** | | **Viti 2018** |
|---|---|---|
| **Numri i rasteve të menaxhuara në total** | | **33** |
| **Sipas grup-moshes** | *0-6 vjeç* | 5 |
| | *7-14 vjeç* | 21 |
| | *15-18 vjeç* | 7 |
| **Sipas gjinise** | *Femra* | 18 |
| | *Meshkuj* | 15 |
| **Sipas institucionit referues** | *NJMF* | 31 |
| | *Policia* | 2 |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

[12] https://alpenews.al/fotot-rrenqethese-ne-bulqize-aty-ku-femijet-jane-te-denuar-pa-femijeri-fotot/

### 3.8.2 Punësimi tek të rinjtë dhe përgatitja për tregun e punës

Nëbashkinë Bulqizë niveli i papunsisëtek të rinjtë e moshës 15-29 vjeçështë nga më të lartët në vend. Kjoështëe lidhur me si me mungesën e ofertës së punës ashtu edhe mundësive të kufizuara për të patur një profesion të kërkuar nga tregu lokal i punës. Deri katër vite më parë, në Bulqizë askush nuk ishte kujdesur për të ngritur një shkollë profesionale që lidhet me trajnimin e të rinjve të lidhur qoftë edhe me industrinë minerare e cila punëson disa mijera punëtorë.

Në vitin 2014, u hap në Bulqizë shkolla e mesme profesionale e cila përgatit të rinjtë në profesionin e teknikut të minierës. Në vitin 2018 është diplomuar brezi i parë i 35 teknikeve. Ngritja e shkollës së mesme profesionale të Bulqizës,ështënjë kontribut që ka dhënë industria e minierave, e cila është kujdesur që ta furnizojë këtë institucion arsimor me bazë materialedhe me ngritjen e një laboratori për praktikën.

### 3.8.3 Gratë me probleme sociale dhe dhuna në familje

Në Bashkinë Bulqizë në vitin 2018 ka trajtuar 11 raste të cilat janë ndjekur me shërbime të ndryshme këshillimi dhe referimi tek insitucionet përkatëse.

Rastet e evidentuara, janë rastet e viktimave të dhunës të pajisura nga gjykata me urdhër të mbrojtjes. Këto raste ndiqen nga kooridnatori lokal për dhunën duke ju ofruar ketyre grave shërbime keshillimi ose duke bëre një vlerësim social ekonomik të familjes në rast se kanë nevojë për mbështetje me ndihmë ekonomike. Ndërkohë që është pothuajse i pamundur identifikkimi i rasteve të tjera të dhunës në familje pasi mungon kultura e denoncimit të dhunës. Rastet e mësipërme janë referuar në situata ekstreme kur kërkohet ndërhyrja e policisë.

**Tabelë 13 - Të dhëna mbi dhunën në familje për vitin 2017-2018**

| | Nr. i rasteve 2017 | Nr. i rasteve 2018 |
|---|---|---|
| Bashkia Bulqizë | 5 | 7 |
| Martanesh | 1 | 1 |
| Shupenzë | 3 | 0 |
| Zerqan | 5 | 0 |
| Gjoricë | 2 | 2 |
| Fushë-Bulqizë | 2 | 0 |
| Ostren | 1 | 1 |
| Trebisht | 0 | 0 |
| Totali | **19 (17 femra)** | **11 (11 femra)** |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

### 3.8.4 Të moshuar të vetmuar

Nëbashkinë Bulqize ka rreth6,160 pensionistë që përfitojnë pension pleqërie. Megjithëse evidentohet si një problem nga diskutimet me grupet e interesit,nuk ka evidenca për numrin e të moshuarve të vetmuar që kanë nevojë për shërbime të kujdesit social e shëndetësor.

Aktualisht në bashki është ngritur një qendër ditore e cila nuk ofron asnjë shërbim social, përveçse një ambjent ku të moshuarit mund të kalojnë një pjesë të kohës.

............. në Bulqizë të moshuarit ndjehen si në burg. Në qendrën e krijuar për ta mungojnë të gjitha kushtet e nevojshme. Të moshuarit që frekuentojnë këtë qendrë thonë se kanë vetëm katër muret, e asgjë më shumë. Sipas tyre, në qendër mungojnë tualetet, ngrohja dhe energjia elektrike. Ata shprehen se pushteti vendor nuk i ka ndihmuar aspak për tju krijuar kushte më komode. Të moshuarit shprehen gjithashtu se nuk bëhet fjalë që të marrin shërbime si të moshuarit në qytete të tjera, me kafe apo çaj gjatë ditës. Ata fajësojnë të gjitha instancat që sipas tyre i kanë harruar në gjithë këto vite Qendra e të moshuarve në Bulqizë ndodhet në lagjen e re të saj, por siç shihet edhe nga pamjet ajo nuk ofron asnjë kusht të përshtatshëm për ta.

*Kronike nga TV Bulqiza*[13]

### 3.8.5 Personat me aftësi të kufizuara (PAK)

Të dhënat e bashkisë Bulqizë tregojnë se numri i personave me aftësi të kufizuar është1,301persona nga të cilët 607 invalidë pune dhe 694 persona me aftësi të kufizuara fizike dhe mendor, te cilët përfitojnë nga skema e pagesës së paaftësisë.Rreth 35% e personave me aftësi të kufizuara përfitojnëpagesëkujdestarie e cila i akordohet personave të tjerë të familjespër të ofruar kujdestari për një ose më shumë anetarë të familjes me aftesi të kufizuara. Brenda grupit të personave me aftësi të kufizuar,grupi më i madh është ai i personaveme probleme të shëndetit mendor. Një pjesë madhe e PAK jetojnë në distancë të konsiderueshme nga qendra e bashkisë, duke bërë të veshtirë marjen e shërbimeve por edhe të pagesës së paaftësisë.

**Tabelë 14 - Numri i personave me aftësi të kufizuar në bashkinë Bulqizë, 2018**

| Njësitë Administrative | Individë me aftesi të kufizuar | Kujdestarë | Invalidët e Punës |
|---|---|---|---|
| Bashkia Bulqizë | 183 | 69 | 259 |
| Fushë-Bulqizë | 36 | 11 | 17 |
| Ostren | 124 | 38 | 95 |
| Shupenzë | 92 | 25 | 65 |
| Gjoricë | 87 | 33 | 70 |
| Zerqan | 74 | 27 | 61 |
| Martanesh | 78 | 15 | 32 |
| Trebisht | 20 | 5 | 8 |
| TOTALI | **694** | **223** | **607** |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

[13] http://www.tvbulqiza.al/te-moshuarit-e-bulqizes-jemi-si-ne-burg/

### 3.8.6 Komunitetet

Në Bashkinë Bulqizë rezultojnë, 21 familje Egjyptiane të cilat për shkak të varfërisë përfitojnë ndihmëekonomike.

### 3.8.7 Familjet e pastreha

Bashkia Bulqizë nuk ka banesa sociale dhe ky shërbim ndodhet nën Drejtorinë e Planifikimit të Territorit. Gjatë viti 2018 kanë aplikuar për strehim social pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit 47 familje, të cilave u është njohur statusi i të pastrehë nga kjo drejtori.
Pamvarësisht mungesës së banesave sociale, marrja e statusit të të pastrehë ofron mundësinë e marrjes së kredive të buta nga bankat për strehim.
Marrja e kredive të buta për strahin bëhet me vendim të këshillit Bashkiak dhe ofrohet për familjet në nëvojë për strehim pas një vlerësimi të kushteve sociale ekonomike të familjes, si dhe pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur në Këshillin Bashkiak. Për vitin 2018 Këshilli Bashkiak ka miratuar kredi favorizuese për tre familje në nevojë.

## 4.Vlerësimi i Kapaciteteve Institucionale, Profesionale dhe Financiare për Ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Social

### 4.1Organizimi i Bashkisë Bulqizë.

Administrata e bashkisë Bulqizë drejtohet nga Kryetari i Bashkisë i cili është i zgjedhur. Kryetari i Bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga dy zëvendëskryetarë. Nga pikëpamja administrative Bashkia Bulqizë përbëhet nga Qyteti dhe shtatë njësi administrative:

1. NjA Fushë – Bulqizë
2. NjA Zerqan
3. NjA Shupenzë
4. NjA Gjoricë
5. NjA Trebisht
6. NjA Ostren
7. NjA Martanesh

Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë e strukturës dhe organikës së bashkisë. Struktura organizative përbëhet nga 8 Drejtori, një nga të cilat është Drejtoria e Shërbimit Social.

### 4.2 Drejtoria e Shërbimit Social

Drejtoria e Shërbimit Social, harton programet e kujdesit social dhe monitoron zbatimin e tyre në territor, me qëllim zbatimin e standardeve dhe rritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve.Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimit Socialharton dhe monitoron programet e shërbimit të strehimi social për familjet e pastreha.

**Tabelë 15 - Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki dhe numri punonjësve sipas struktures**

| Nr. | Emërtesa e pozicionit | Nr. i punonjësve |
|---|---|---|
| **1** | Drejtor | 1 |
| **2** | Specialist i Ndihmës Ekonomike | 1 |
| **3** | Specialist i paaftesisë dhe invalidëve të punës | 1 |
| **4** | Specialist i barazisë gjinore dhe dhunës në familje | 1 |
| **5** | Specialist i NJMF | 1 |
| **6** | Specialistët e qendrës PAK | 4 |
| **7** | Sanitare | 1 |
| **8** | Administrator shoqëror të ndihmës ekonomike në Njësitë Administrative | 7 |
| | **TOTALI** | **17** |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

**4.3 Shërbimet egzistuese të kujdesit social**

Ndër shërbimet e konsoliduara të përkujdesit shoqëror që ofron Bashkia Bulqizë, mund të përmendim shërbimet për fëmijët të cilat ofrohen nga Njësia e Mbrojtjse së Fëmijës. Identifikimi dhe verifikimi i rasteve në nevojë realizohet përmes skuadrave të terrenit, të cilat janë ngritur për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge si dhe monitorimin e situatës së fëmijëve që shfrytëzohen për lypje. Gjithashtu skuadrat e terrenit verifikojnërastet e të gjitha grupeve në nevojë.

**Tabelë 16 - Shërbimet e përkujdesit për fëmijë**

| Nr. | Institucioni | Ditore | Kapaciteti Max | Kapaciteti aktual | Mosha 0-6 | Mosha 16-18 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Qendra e Zhvillimit per fëmijët me aftësi të kufizuar* | *Po* | *18-25* | *14* | *14* | *0* |

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimit Social Bulqizë*

**Shërbimet për Viktimat e Dhunës në familje.**Në bashkinë Bulqizë funksionon **Mekanizmi i Referimit** i cili bazohet ne Ligjin 9669 të datës 18.02.2006 dhe VKM nr.334 datë 17.02.2011 është ngritur në 2016. Në përbërje të tij janë Kryetari i Bashkisë Bulqizë, Drejtori i Komisariatit të policisë, një përfaqësues i Drejtorisë së Spitalit, Drejtorisë së Shëndetit Publik, Nënprefektura Bulqizë, mjeku ligjor dhe Zyra e Punësimit.

Një nga sfidat për fuksionimin e mekanizmit mbetet mungesa e përfaqsimit të Gjykatës, prokurorisë dhe zyrës së përmbarimit të cilat ndodhen në Peshkopi dhe nuk janë pjesë e këtij Mekanizmi. Grupi i punës mblidhet 6 herë në vit për të diskutuar për raste konkrete të cilat kërkojnë një menaxhim të veçantë dhe shërbime. Numri më i madh i rasteve të dhunës është regjistruar në qytetin e Bulqizës.

**4.5 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime të kujdesit social**

Stafi i Drejtorise së Shërbimeve të Kujdesit Social në Bashkinë Bulqizë, ka arsimin e duhur sipas profileve që kërkohet nga përshkrimi i vendit të punës. Në njësitë administrative

mungojnë*"Njësitë për Vlerësimin dhe Referimin e Rasteve"*. Megjithatë nevoja për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e tyreështënjë domosdoshmëri e përhershme për disa arsye; së pari, ndryshimet social ekonomike që kanë ndodhur nëshoqërinë shqiptare, kanë prezantuar edhe fenomene të reja sociale dhe grupe të reja me nevoja të veçanta; së dyti, ashtu si nëçdo fushë edhe lënda e shërbimeve sociale ka evoluar duke sjellë koncepte të reja për shërbimet, qasje të reja për adresimin e nevojave të grupeve të prekura si dhe standarde të reja të shërbimeve te ofruara; sëtreti,Ligjin nr. 121/ 2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ka përcaktuar detyra te reja per administratën lokale të shërbimeve sociale; së katërti, ndryshimet në madhësinë e territorit që menaxhon bashkia, kërkon një tjetër organizim dhe përgatitje të stafeve që punojnë per ofrimin e shërbimeve sociale.

Nevoja për kualifikime e stafit, është e lidhur me punën në terren si psh: njohuritë e punonjësve social për menaxhimin efektiv tërasteve, zhvillimineplaneve të punës dhe planeve individuale nga ana e administratoreve social, si dhe njohuri mbi tipologjinë e nevojave për shërbime sociale,

Mungesa enjohurive të thelluara te NjMF-ve dhe 'Mekanizmit" për identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për grupe të veçanta siç janë shërbimet për viktimat e dhunës në familje dhe abuzimit të fëmijëve, janë çështje që duhen adresuar me shpejtësi për shkak të intensitetit të shfaqjes së këtyre nevojave në shoqërinë shqiptare.

Një sfidë tjetër me të cilën duhet të përballen punonjësit dhe administratortët social, si pjesëe e administratës vendore është menaxhimi apo monitorimi i organizatave që operojne në territor. Bashkia duhet të plotesojë nevojat për kujdes social të grupeve të veçanta dhe për këtë duhet të bashkëpunojë me organizatat që i ofrojnë këto shërbime, por nga ana tjetër duhet të kujdeset që shërbimet e ofruara të jenë cilësore dhe sipas standarteve.

### 4.6 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale nëbashkinë Bulqizë.

